

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

By July 28 - Apply for the "Western Balkans Purchasing Initiative"

DIRECTOR'S NOTE

Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,

Javën që po lëjmë pas angazhimi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ekipit të saj ka qenë në disa drejtime, duke shënuar edhe suksese. Po ndajmë me ju një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme dhe fotografi nga këto ngjarje:

Dear members of the German-Kosovar Business Association,

The week that we are leaving behind, the engagement of the German-Kosovar Business Association and its team has been in several directions, marking successes as well. We are sharing with you a summary of important events and photographs from these events:

U mbajt diskutimi Chat GPT dhe implikimet e tij

Përdorimi i Chat GPT tashmë ka prekur gjithë masën, duke u konsideruar si një asistent dixhital, i cili punon për ju pavarësisht kërkesave që i bën. Mirëpo, gjithmonë ekziston një aspekt që duhet diskutuar rreth mbrojtjes së të dhënave dhe pronësisë intelektuale.

Sot në ambientet e Qendrës së Trajnimeve të ProCredit Bank, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka mbajtur diskutimin për ChatGPT dhe implikimet e tij, me ekspertët e fushave që prek ky përdorim: Krenare Sogojeva Dermaku - Agjencia për Informim dhe Privatësi, Drinor Selmanaj - Sentry Cybersecurity dhe avokati Florin Lata nga Shoqëria e Avokatëve "Vokshi&Lata".

Përgjatë diskutimit dolën përfundime shumë të vlefshme:


Discussion held on Chat GPT and its implications

The use of Chat GPT has already reached a wide audience, being considered as a digital assistant that works for you regardless of the requests you make. However, there is always an aspect that needs to be discussed regarding data protection and intellectual property.

Today, in the premises of the ProCredit Bank Training Center, the German-Kosovar Business Association held a discussion on ChatGPT and its implications, with experts from the fields affected by this use: Krenare Sogojeva Dermaku - Information and Privacy Agency, Drinor Selmanaj - Sentry Cybersecurity, and lawyer Florin Lata from the Law Firm "Vokshi & Lata".

During the discussion, valuable conclusions were drawn:

- E ardhmja e bizneseve dhe institucioneve varet nga maksimizimi i përdorimit të teknologjive të reja
- Kompanitë dhe institucionet duhet të investojnë rregullisht në trajnime të stafit për sigurinë kibernetike dhe përdorim të platformave teknologjike.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale si në rastin e ChatGPT duhet të ketë kujdes për mospërdorim të të dhënave personale
- Një zyrtar për mbrojtje të të dhënave duhet të jetë në secilën kompani dhe institucion.
- Kodimi si lëndë mësimore krahas matematikës në shkolla fillore, teksa në të mesme edhe AI
- E drejta e pronësisë intelektuale dhe e drejtës së autorit do të pësojë ndryshime drastike në 5 vitet e ardhshme, për shkak të impaktit të paimagjinueshëm që do të ketë AI.
- The future of businesses and institutions depends on maximizing the use of new technologies.
- Companies and institutions should regularly invest in staff training for cybersecurity and the use of technological platforms.
- The use of artificial intelligence, such as in the case of ChatGPT, should be cautious to avoid the misuse of personal data.
- A data protection officer should be present in every company and institution.
- Coding should be taught as a subject alongside mathematics in primary schools, and AI in secondary schools.
- Intellectual property rights and the right to authorship will undergo drastic changes in the next 5 years due to the unimaginable impact AI will have.



Çka është CYBER HYGIENE (Higjiena Kibernetike)? **What is CYBER HYGIENE?**

"Cyber hygiene" është një term i përdorur për të përshkruar praktikat dhe masat e ndërmarra për të mbrojtur dhe ruajtur sigurinë e informacionit dhe të të dhënave në mjedisin kibernetik të organizatës ose kompanisë. Ajo përfshin një sërë rregullash, politikash dhe veprimeve të sigurisë që ndihmojnë në parandalimin e rreziqeve kibernetike dhe në mbrojtjen e sistemeve të kompjuterëve dhe të rrjeteve.

"Cyber hygiene" is a term used to describe the practices and measures taken to protect and maintain the security of information and data in the organization's or company's cyber environment. It encompasses a set of rules, policies, and security actions that help prevent cyber risks and protect computer systems and networks.

Disa aspekte të cyber hygiene janë:

1. Përdorimi i fjalekalimeve komplekse dhe të vështira për tu kalkuluar është një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e të dhënave personale dhe të sistemeve.
2. Instalimi i një softueri antivirus dhe i një zbuluesi të malware-ve ndihmon në zbulimin dhe parandalimin e infeksioneve të dëmshme në kompjuterë.
3. Përdorimi i mendimit kritik për të identifikuar e-mailet dhe faqet e internetit të dyshimta, dhe mos-hapja e të dhënave personale nëpërmjet emailave të dyshimta ose lidhjeve të paqarta.
4. Njerëzit duhet të jenë të vetëdijshëm për informacionin që ndajnë në mediat sociale dhe të kufizojnë qasjen e të tjerëve në të dhënat e tyre personale.

Nëse dëshironi të organizoni trajnim për kompaninë tuaj rreth sigurisë kibernetike, atë mund ta bëni përmes OEGJK-së, duke shkruar në info@oegjk.org.

Some aspects of cyber hygiene include:

1. Using complex and hard-to-guess passwords is an important step in protecting personal data and systems.
2. Installing antivirus software and malware detectors help detect and prevent harmful infections on computers.
3. Using critical thinking to identify suspicious emails and websites and avoiding opening personal data through suspicious emails or unclear links.
4. People should be aware of the information they share on social media and limit others' access to their personal data.

If you wish to organize a cybersecurity training for your company, you can do so through the German-Kosovar Business Association by writing to info@oegjk.org.

Drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani mori pjesë në OpenDay të SharrCem - Titan Cement Group



Një nga prodhuesit më të mëdhenj të çimentos, SharrCem SH.P.K - Titan Cement Group mbajti gjatë javës OpenDay, ku u shpalosën praktikat e EGS-së që kjo kompani i zbaton dhe përkushtimin e thellë për të implementuar objektivat mjedisore, sociale dhe qeverisëse.

Drejtoresha ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani në fjalën e saj tha se menaxhmenti dhe punëtorët e kësaj kompanie duhet të jenë krenarë me të arriturat që kanë një vazhdimësi të palëkundur.

The Director of the German-Kosovar Business Association, Nora Hasani, participated in the Open Day of SharrCem - Titan Cement Group.

One of the largest cement producers, SharrCem SH.P.K - Titan Cement Group, held an Open Day during the week, where they showcased their ESG practices and deep commitment to implementing environmental, social, and governance objectives.

The Executive Director of the German-Kosovar Business Association, Nora Hasani, stated in her speech that the management and employees of this company should be proud of their continuous achievements.



Vizitë tel VitaFood, që ka angazhuar ekspert nëpërmes shërbimit SES që ofron OEGJK-ja

Ekipi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare ka vizituar kompaninë anëtare Vita Food. Kjo vizitë pati edhe një rast të veçantë.

Koleget Greta Kazia dhe Besarta Hyseni patën mundësi që të takohen edhe me ekspertin gjerman, Wilhelm Renn, që është angazhuar nëpërmes Senior Expert Service (SES), që ofrohet ekskluzivisht nga OEGJK.

Kompania Vita Food po përfiton çdo ditë e më shumë nga përvoja e ekspertit Renn, i cili është angazhuar për receta të reja edhe për maksimalizim të prodhimit.

Përgjatë takimit u bisedua gjatë për mundësitë e zgjerimit të biznesit në tregun gjerman.

Visit at VitaFood, which has engaged an expert through the SES service provided by the German-Kosovar Business Association.

The team of the German-Kosovar Business Association visited the member company Vita Food. This visit also had a special occasion.

Colleagues Greta Kazia and Besarta Hyseni had the opportunity to meet with the German expert, Wilhelm Renn, who has been engaged through the Senior Expert Service (SES) exclusively provided by the KDWV.

Vita Food is benefiting more and more each day from the expertise of expert Renn, who is engaged in developing new recipes and maximizing production.

During the meeting, there were extensive discussions about business expansion opportunities in the German market.



Kompani të reja u bashkangjiten në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare

Kompani tjera i bashkohen Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare për të qenë pjesë e një grupi tashmë 200 anëtarësh nga të gjitha veprimtaritë ekonomike.

Kompanive të reja anëtare Paysera, Sentry Cybersecurity, German School Kosova dhe Kooperativa në një takim miqësor në zyrat tona iu prezantuan të gjitha shërbimet dhe përparësitë që përfitojnë nga të qenit anëtarë në OEGJK.

Kompanitë anëtare gjithashtu janë përfituese të shërbimeve që ofrojnë anëtarët tjerë, Members for Members, për të cilat mund të jenë edhe shërbim-ofrues.

New companies have joined the German-Kosovar Business Association.

Other companies have joined the German-Kosovar Business Association to be part of a group that now consists of 200 members from all economic sectors.

During a friendly meeting at our offices, the newly joined member companies, Paysera, Sentry Cybersecurity, German School Kosova, and Kooperativa, were introduced to all the services and benefits they gain from being members of the KDWW.

Member companies are also beneficiaries of the services offered by other members, Members for Members, where they can also be service providers.



U mbajt "Business After Hours" i OEGJK-së

Tradita e takimit jo-formal mes anëtarëve në ngjarjen e për-muajshme "Business After Hours" po vazhdon.

Kësaj radhe u takuam për të biseduar rreth zhvillimeve të odës dhe kompanive anëtare, duke shpalosur ide të reja, por edhe duke ndihmuar njëri-tjetrin në gjetjen e rrugëve më të shpejta për zgjidhje.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm që gjithmonë jep rezultat në këtë ngjarje është rrjetizimi dhe arritja e lajmeve brenda sektorit më shpejt se sa gjithçka tjetër, përmes komunikimit të ndërsjellë mes anëtarëve.

KDWV's "Business After Hours" was held

The tradition of informal meetings among members continues with the monthly "Business After Hours" event.

This time, we gathered to discuss the developments of the association and member companies, sharing new ideas and helping each other find faster solutions.

One crucial aspect that always yields results in this event is networking and the rapid dissemination of news within the sector through mutual communication among members.



OEGJK mori pjesë Punëtorinë e Zyrës për Planifikim Strategjik pranë ZK-së, për Procesin e Analizës së Ndërmarrësisë

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare është përfaqësuar nga Sytrime Dervisholli, drejtuese e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie Qeveritare në punëtorinë 2-ditore të organizuar nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyres së Kryeministrit lidhur me Procesin e Analizës së Ndërmarrësisë (EDP).

Aty është prezantuar puna e deritanishme, përkatësisht rezultateve të procesit të EDP-së si dhe diskutimi në lidhje me shqyrtimin e koncepteve kryesore për instrumentet e politikave dhe monitorimin e tyre.

Fokusi i punëtorisë ishte në aspektet kryesore të menaxhimit të zbatimit dhe hapat e ardhshëm, duke u bazuar në kornizën metodologjike të Joint Research Centre.

The German-Kosovar Business Association participated in the Workshop of the Office for Strategic Planning at the Chamber of Commerce, focusing on the Entrepreneurship Analysis Process

The German-Kosovar Business Association was represented by Sytrime Dervisholli, Head of the Department for Advocacy and Governmental Relations, at the 2-day workshop organized by the Office for Strategic Planning under the Office of the Prime Minister regarding the Entrepreneurship Analysis Process (EDP).

During the workshop, the work done so far, specifically the results of the EDP process, were presented, and there were discussions regarding the examination of key concepts for policy instruments and their monitoring.

The focus of the workshop was on the key aspects of implementation management and the next steps, based on the methodological framework of the Joint Research Centre.

OEGJK mori pjesë në "Inteligjenca Artificiale dhe Industria në Kosovë"

Ekipi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare ka marrë pjesë në panelin e diskutimit me temën "Inteligjenca Artificiale dhe Industria në Kosovë", e cila u mbajt në kuadër të Simpoziumit të Diasporës në ICT me temën "Inteligjenca Artificiale Kosova".

Gjatë këtij paneli diskutuan shumë personalitete të rëndësishme nga universiteti dhe industria, vendor dhe nga Diaspora, të cilët prezantuan risite më të reja nga fusha e inteligjencës artificiale.



The German-Kosovar Business Association participated in the event titled "Artificial Intelligence and the Industry in Kosovo"

The team of the German-Kosovar Business Association participated in the panel discussion on "Artificial Intelligence and the Industry in Kosovo," held as part of the ICT Diaspora Symposium with the theme "Artificial Intelligence Kosovo."

During this panel, various important personalities from academia and the local industry, as well as from the diaspora, discussed and presented the latest advancements in the field of artificial intelligence.



Të gjetura nga Kosovo IT Barometer 2021 - 2022

Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë (STIKK) ka publikuar raportin "Kosovo IT Barometer 2021 - 2022".

Më poshtë po ju listojmë disa prej të gjeturave të këtij raporti:

- 83% e kompanive të sektorit TIK janë në pronësi të burrave, ndërsa 17% kanë pronare gra.
- Kompanitë me qarkullim vjetor mbi 500,000 euro përbëjnë 34% të sektorit, duke treguar praninë e kompanive me burime dhe operacione të konsiderueshme financiare.
- Shumica (50%) e të anketuarve janë identifikuar si zhvillues të produkteve softuerike.
- 85% e kompanive eksportojnë shërbime/produkte dhe ndër to 39% janë të fokusuar vetëm në tregjet ndërkombëtare.
- Kompanitë në pronësi të grave priren të kenë një përqindje më të lartë të punonjësve gra krahasuar me kompanitë në pronësi të burrave.
- Paga mesatare mujore në sektorin e TIK varion nga 800 euro deri në 3,200 euro, në varësi të pozicionit dhe karakteristikave të kompanisë.
- Kompanive u duhen të paktën dy muaj për të zëvendësuar punonjësit që largohen dhe deri në 6 muaj për pozicione më të specializuara.
- Një shumicë dërrmuese (74%) e kompanive raportuan se përballen me një deficit të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Findings from the Kosovo IT Barometer 2021-2022

The Information and Communication Technology Association of Kosovo (STIKK) has published the report "Kosovo IT Barometer 2021-2022".

Below are some of the findings from this report:

- 83% of ICT sector companies are male-owned, while 17% are female-owned.
- Companies with an annual turnover of over 500,000 euros make up 34% of the sector, indicating the presence of companies with significant financial resources and operations.
- The majority (50%) of respondents were identified as software product developers.
- 85% of companies export services/products, with 39% exclusively focusing on international markets.
- Female-owned companies tend to have a higher percentage of female employees compared to male-owned companies.
- The average monthly salary in the ICT sector ranges from 800 euros to 3,200 euros, depending on the position and company characteristics.
- Companies require at least two months to replace departing employees and up to six months for more specialized positions.
- An overwhelming majority (74%) of companies reported facing a shortage of qualified workforce.

Ftesa për aplikim të kompanive anëtare

Aplikoni deri më 28 korrik për "Western Balkans Purchasing Initiative"

Më 12 Tetor 2023, në Köln do të mbahet konferenca një-ditore "Western Balkans Purchasing Initiative", që organizohet nga Asociacioni Federal për Menaxhimin e Zingjirit të furnizimit, Blerje dhe Logjistikë (BME) në bashkëpunim me Ministrinë Federale gjermane për Ekonomi si dhe Odat Ekonomike Gjermane të Jashtme, të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Aty është vendi më ideal për takime B2B dhe për të hapur horizonte të reja në tregun ndërkombëtar.

Jemi të lumtur të ju njoftojmë se deri tani rreth 50 kompani blerëse janë regjistruar në platformën e takimeve të BME-Matchmaking-Plattform për Western Balkans Purchasing Initiative 2023.

Aplikoni deri më **28 korrik 2023** në <https://www.bmematchmaking.com/login> ose kontaktoni në info@oegjk.org për informacione tjera shtesë.

Invitation for Applications from Member Companies

Apply by July 28 for the "Western Balkans Purchasing Initiative"

On October 12, 2023, the one-day conference "Western Balkans Purchasing Initiative" will take place in Cologne, organized by the Federal Association for Supply Chain Management, Procurement, and Logistics (BME) in collaboration with the German Federal Ministry for Economic Affairs and the German Foreign Chambers of Commerce from the Western Balkan countries.

It is an ideal place for B2B meetings and to explore new opportunities in the international market.

We are pleased to inform you that around 50 buyer companies have already registered on the BME-Matchmaking-Plattform for the Western Balkans Purchasing Initiative 2023.

Apply by **July 28 2023** at <https://www.bmematchmaking.com/login> or contact us at info@oegjk.org for further information.

Fitoni përkrahje nga KIESA për pjesëmarrje në Panairin më të madh për marketingut dhe IT - DMXCO 2023

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA ka publikuar thirrjen publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin "DMEXCO 2023", (Digital marketing expo & conference) në Köln të Gjermanisë, më 20-21 Shtator 2023.

Paraqitja shtetërore organizohet nga MINT përkatësisht KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e standës, regjistrimin e dhjetë (10) subjekteve pjesëmarrëse [tri (3) prej tyre startup (e themeluar 1-5 vjetet e fundit)], shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj.

Aplikoni duke ndjekur hapat në këtë link: <https://kiesa.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,5,710>.

DMEXCO është ngjarja kryesore e marketingut dhe teknologjisë digjitale në Evropë, si vendtakim për akterët kyq në biznesin digjital, marketingun dhe inovacionin: <https://dmexco.com/conference/>.

Faleminderit!

Gain support from KIESA to participate in DMXCO 2023, the largest trade fair for marketing and IT

The Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA) has published a public call for applications to participate in Kosovo's national booth at the "DMEXCO 2023" (Digital marketing expo & conference) trade fair in Cologne, Germany, on September 20-21, 2023.

The state presentation is organized by the Ministry of Economy, i.e., KIESA, which covers the expenses for the exhibition space, booth construction, registration of ten (10) participating entities [three (3) of them being startups (established within the last 1-5 years)], electricity costs, daily cleaning, etc.

Apply by following the steps in this link: <https://kiesa.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,5,710>.

DMEXCO is the premier event for marketing and digital technology in Europe, serving as a meeting place for key players in digital business, marketing, and innovation: <https://dmexco.com/conference/>.

Thank you!

↓ MORE INFORMATION BELOW ↓

YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Znj. Sytrime Dervisholli,
Udhëheqëse e departamentit
për marrëdhënie me qeverinë
dhe avokim mund ta
kontaktoni në:

sytrime.dervisholli@oegjk.org

Sytrime Dervisholli, Head of
Department for Government
Relations and Advocacy can
be contacted at:

sytrime.dervisholli@oegjk.org

Ekipi i znj. Dervisholli nuk është vetëm përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve, por gjithashtu koordinon gjashtë grupet punuese të OEGJK-së, dhe punon në publikimet tona, si dhe në raportet sektoriale:

[Publikimet e OEGJK-së](#)

The team of Ms. Dervisholli is not only responsible for representing the interests of KDWV-members, but also coordinates the six working groups of KDWV, and works on our publications, as well as on sector reports:

[Publications](#)



Udhëheqëse e
departamentit për
mbështetjen dhe
shërbimet e anëtarëve
është znj. znj. Besarta
Hyseni:

besarta.hyseni@oegjk.org

Head of Market Entry and
Events is:

besarta.hyseni@oegjk.org

Ekipi i znj. Hyseni jo vetëm që mbështet anëtarët me eksport, këshilla ligjore (kemi këshilltarë ligjorë në ekip), këshilla për Joint Venture, Franchise dhe Senior Expert Service, por gjithashtu organizon takime B2B, udhëtime delegacioni, punëtori dhe ngjarje informuese për anëtarët.

The team of Ms. Hyseni not only supports members regarding export, legal advisory services (KDWV has in-house lawyers), Joint Venture, Franchise and Senior Expert Service, but also organizes B2B meetings, delegation trips, workshops, and info-sessions for members.



Për çështje financiare (pagesa
e anëtarësimit/faturat etj.)
mund ta kontaktoni znj. Greta
Kazia:

greta.kazia@oegjk.org

For financial matters
(membership fees/invoices,
etc.) please contact Ms. Greta
Kazia:

greta.kazia@oegjk.org



Për këshillim ligjor të
investitorëve gjerman dhe
anëtarëve të OEGJK mund
ta kontaktoni znj. Gonxhe
Abazi:

gonxhe.abazi@oegjk.org

For legal advice to German
Investors and members of
KDWV please contact Ms.
Gonxhe Abazi:

gonxhe.abazi@oegjk.org

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.30 - 16.30